# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-455583**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Probleme me AKSHI-n!” Biblioteka dy vjet pa sistem digjital - Shqiptarja.com |
| ADRESA | `https://shqiptarja.com/lajm/probleme-me-akshin-biblioteka-dy-vjet-pa-sistem-digjital` |
| BURIMI | shqiptarja.com |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 18 shtator 2026, 14:50:39 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 18 shtator 2026, 14:45:31 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `3aeb938e9e61108f7559e078703b465ad93018ac0a4337b0d11653ac64de12b6` |
| TEKSTI | `9deb6bfdaad9d1de5fb068ca8b4cde46939915a61f09fa107e14bd57c1fe3638` |
| PAMJA | `76c20a8569f9e72a8cd231ec16d275ca81ccc8b1ecca4688e387444ebe5b4998` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `66ae09a628ab10f8da4ab46a4e4ab3b566360b8b4cbd96d7df6b562114fb02ae` |
| E MËPARSHMJA | `f44283a3228666c73da2558b258bb0ff0218cbc6e3f0505a2ff98ce5370962ec` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/66ae09a628ab10f8da4ab46a4e4ab3b566360b8b4cbd96d7df6b562114fb02ae`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px




Kultura

# “Probleme me AKSHI-n!” Biblioteka dy vjet pa sistem digjital

*Sistemi i digjitalizimit të Bibliotekës Kombëtare, ALIS, si dhe një server dhuruar nga BE, kanë mbetur jashtë funksionit. Në Komisionin Parlamentar të Kulturës, përfaqësuesit e Bibliotekës bënë sot përgjegjës për situatën e krijuar Agjencinë Kombëtare të Agjencisë së Informacionit, e cila ende nuk ka lidhur kontratë për mirambajtjen e sistemit.*

Blerina Goce
18 Shtator, 16:40 | **Përditesimi: 18 Shtator, 18:36**

Share Tweet

HOROSKOPI


ALIS është sistemi përmes të cilit realizohet katalogimi dhe pasurimi i fondit të Bibliotekës Kombëtare, administrimi i periodikëve, anëtarësimi, huazimi dhe raportimi, duke i bërë këto procese më të organizuara dhe efikase. Të dhënat bibliografike janë të aksesueshme për publikun përmes katalogut online OPAC, ndërsa ndërveprimi i ALIS me portalin e-Albania mundëson ofrimin elektronik të disa prej shërbimeve të Bibliotekës Kombëtare.

Por, siç bëri të ditur përfaqësuesi i Bibliotekës Kombëtare, Besmir Lumani, ky sistem prej kohësh ka rreshtuar së funksionuari.

> *“Ky sistem ka dy vjet që është komplet jashtë funksionit sepse ka mbaruar kontrata e shërbimit midis AKSHI-t dhe operatorit ekonomik fitues”, tha përfaqësuesi i Bibliotekës Kombëtare, Besmir Lumani.*

[Sh] .com

LEXO EDHE:
***Vrasja në Sarandë/ Zhupa: 4 ngjarje të rënda në sagën e hakmarrjeve që e di gjithë qyteti, policia të reformohet***

Në Komisionin Parlamentar të Kulturës, Lumani zbuloi dhe një fakt tjetër. Serveri dhuruar nga Bashkimi Evropian përmes programit UNOPS, ka mbetur po ashtu pa u vënë në punë

> *“Kemi pengesa me digjitalizimin dhe memorjen e brendshme, pasi AKSHI ka nxjerrë jashtë përdorimit hardisqet e jashtme. Serverat na ndihmojnë, por nuk janë vënë ende në punë.”, vijoi Lumani.*

Kryetarja e Komisionit, Ina Zhupa, e cilësoi këtë situatë si një bllokim që cënon drejtpërdrejt qytetarët dhe trashëgiminë kulturore, ndërsa kërkoi ndërhyrje institucionalisht.

> *“Si komision, me njohjen e kësaj problematike, t’i drejtohemi AKSHI-t me një kërkesë zyrtare për të shtyrë më tej këtë çështje, sepse bëhet fjalë për kulturën kombëtare dhe identitetin. Biblioteka u shërben qytetarëve shqiptarë. Është e paarsyeshme që serverat e dhuruar nga UNOPSI të mos vihen në funksion për shkak të problematikave të AKSHI-t. Është detyra jonë ta kthejmë vëmendjen te kjo çështje.”, tha Ina Zhupa, kryetare e Komisionit për Kulturën.*

Biblioteka në fakt nuk është i vetmi institucion që përballet me mungesën e shërbimeve që duhet të garantohen nga AKSHI. Që kur përfundoi nën hetim, pjesa dërrmuese e shërbimeve që kalonin përmes saj, kanë stopuar. Qeveria ka ngritur një shoqëri me kapital shtetëror, Albania Digital Solutions, e cila do të ofrojë tanimë shërbimet pa kaluar te privati. Drejtuesit e Bibliotekës Kombëtare shpjeguan për “Report TV”, se brenda disa javësh presin që problemi të tejkalohet.

B.G/E.H/Shqiptarja.com

TAG: Ina Zhupa | Komisioni per Kulturen | Biblioteka Kombëtare

Sa e vlerësoni këtë artikull? ★ ★ ★ ★ ★

LAJMET MË TË VLERËSUARA

Komente

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.com

**Sondazhi i ditës:** 16 Shtator, 14:18

**Haga dënon me 81 vite burg 4 ish-krerët e UÇK-së, si e vlerësoni?**

Të drejtë | Të gabuar | Nuk e di

## Lajme të tjera



Kopshtet dhe çerdhet në Sarandë/ Zhupa: Deri në 70 fëmijë në një klasë, bashkia të përfundojë punimet (VIDEO)

19 Shtator, 12:46



E drejta e autorit dhe problematikat, pr.ligji përforcon mbrojtjen! Dëgjesa me Arkivin e Filmit dhe QKK-në për materialet online



Blerina Goce

15 Shtator, 14:20



Platforma 'Pasqyrë Albania', Zhupa-Ramës: Nëse do realisht të dëgjosh qytetarët, jep dorëheqjen!

3 Shtator, 14:32



TID Durrës, Zhupa: Ka ndryshuar baza juridike, të ndalet dhe anulohet menjëherë projekti

2 Shtator, 11:56



Ina Zhupa: 'The Albanian Files' kundër interesit publik, Shqipëria e projektuar për oligarkët!

30 Gusht, 11:04



Më pak mbrojtje, më shumë tarifa/ Zhupa: Qeveria betonizon zonat e mbrojtura dhe faturon qytetarët, 5-fish rritja e tarifave!

28 Gusht, 12:32



Platformat e qeverisë për të 'folur' me qytetarët, reagon Ina Zhupa: Versione të ripërpunuara të propagandës së vjetër!

24 Gusht, 17:53



'Denis Sinani në krye të Qarkullimit në Sarandë', Ina Zhupa kërkon sqarime: Kush e mori këtë vendim dhe mbi çfarë kriteresh u emërua?

23 Gusht, 15:49



Kabinat elektrike në Sarandë ftohen me freskuese, Zhupa: Çështje serioze sigurie, duhen masa dhe inspektim urgjent

16 Gusht, 13:01



Ina Zhupa denoncon ndotjen e detit në Porto Palermo: Pushuesit dolën me njolla vaji nga uji, ku janë institucionet?



Strukturat audituese të universiteteve kalojnë në varësi të rektorit, Zhupa: Kumbaro udhëzime antiligjore



Këshilli i Sarandës miraton vendimin, parkim publik në territorin e gjimnazit 'Hasan Tahsini'! PD: Skandal, cenohet




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.